

Hapet thirrja për aplikime për studentët në Universitetin Clermont Auvergne, në Francë, në kuadër të Programit Erasmus +, për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Clermont Auvergne, në Francë për semestrin e parë për vitin akademik 2019-2020.

<https://www.uca.fr/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Master;

Kohëzgjatja e bursave:

- Master (5 muaj);

Fushat e studimit:

-Gjuhë Frënge.

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj për studentët);

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

➤ **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:**

- CV (në gjuhën angleze/frënge);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose frënge);
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Listë notash e nivelit Bachelor (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose frënge);
- Listë notash e nivelit Master (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose frënge);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze/frënge;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Frëngjisht B1);
- *Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Clermont Auvergne lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatorin Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Learning_agreement_for_studies_Erasmus.docx

Afati për aplikim: 26 Prill 2019.

Dokumentacioni duhet dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe të skanuara të dërgohen në adresën iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron Suksese në aplikim!